



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI PORTUAL DURRËS  
DIVIZIONI LIGJOR DHE ADMINISTRATËS

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Durrës, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**( NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

**Drejtuar:** “Univers Promotions” Shpk

**Adresa:** Tiranë, Kashar, Qafa e Kasharit, Mbikalimi i Rinasit.

Procedura e prokurimit/lotit: “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar – Mallra ”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-77573-08-16-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Veshmbathje”** - 45 (dyzetë e pesë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.70 datë 21 Gusht 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “Malbertex” Shpk me NIPT K71821009N me vlerë të ofertës ekonomike 8 945 500 (tetë milion e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.
2. “Muca” Shpk me NIPT K01421002H i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
3. “Univers Promotions” Shpk me NIPT K81324039M me vlerë të ofertës ekonomike 8 759 000 (tetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori “Malbertex” Shpk, me NIPT K71821009N nuk i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në dokumentat e tenderit, dhe për rrjedhojë KVO vendosi të mos e kualifikoje këtë ofertë për arsyet e mëposhtme:
  - a. Operatori Ekonomik nuk ka përmbushur pikën 1/b me formulimin e mëposhtëm:
    1. Ofertuesi duhet të paraqesë: Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.
  - b. Operatori Ekonomik nuk ka përmbushur pikën 2.3.2 me formulimin e mëposhtëm:

2.3.2 Kandidat/Operatori Ekonomik Ofertues, në rast se nuk është prodhues për të gjithë artikujt, objekt i kësaj procedure prokurimi, duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesit ose distributor i autorizuar, i cili merr përsipër të furnizojë Kandidatin me artikujt objekt prokurimi. Në rastin e distributorit të autorizuar, të paraqitet edhe dokumenti që vërteton lidhjen e distributorit të autorizuar me firmën prodhuese. (Autorizimi i prodhuesit duhet të përmbajë të dhënat të plota kontaktuese të prodhuesit si, telefon, email, website).
  - c. Operatori Ekonomik nuk ka përmbushur pikën 2.3.8 me formulimin e mëposhtëm:

2.3.8 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë certifikatën OEKO TEX STANDARD 100 ose ekuivalente (të lëshuar në emër të tij ose të prodhuesit) për artikujt corape burrash, bluze pambuku me minge të shkurtra me tre kopsa dhe kostum sportiv dimeror.
  - d. Operatori Ekonomik nuk ka përmbushur pikën 2.3.9/a me formulimin e mëposhtëm: Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë certifikatën të produktit final (të lëshuara në emër të tij ose të prodhuesit) që vërtetojnë se mallrat objekt prokurimi, veshjet e mirëmbajtjes, janë në përputhje me parametrat teknike të dhëna të specifikimeve teknike dhe me standartet e mëposhtme kombetare/nderkombetare ose ekuivalente, të njohur nga Standardet shqiptare S.SH.EN.
    - Jelek fosforeshent me xhepa dhe zinxhir: S.SH. EN ISO 13688:2013 dhe S.SH. EN ISO 20471:2013+A1:2016klasi I
  - e. Operatori Ekonomik nuk ka përmbushur pikën 2.3.9/b me formulimin e mëposhtëm: Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë certifikatën të produktit final (të lëshuara në emër të tij ose të prodhuesit) që vërtetojnë se mallrat objekt prokurimi, veshjet e mirëmbajtjes, janë në përputhje me parametrat teknike të dhëna të specifikimeve teknike dhe me standartet e mëposhtme kombetare/nderkombetare ose ekuivalente, të njohur nga Standardet shqiptare S.SH.EN.

- Veshje speciale kunder zjarrit: S.SH. EN ISO 469:2005

- f. Operatori Ekonomik nuk ka përmbushur pikën 2.3.10 me formulimin e mëposhtëm: Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë mostra për të gjithë artikujt e kësaj procedure prokurimi publik, për të vërtetuar përputhshmërinë e tyre me përshkrimet fizike tek specifikimeve teknike.
  - g. Operatori Ekonomik nuk ka përmbushur pikën 2.3.11 me formulimin e mëposhtëm: Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në tender një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë mbi vendndodhjen e makinerive dhe pajisjeve të kërkuara, si për ato në pronësi, ashtu edhe për ato me qira, si dhe autorizon entin/autoritetin kontraktor të bëjë verifikimin fizik të tyre, me apo pa paralajmërim paraprak.
  - h. Operatori Ekonomik nuk ka përmbushur pikën 2.3.12 me formulimin e mëposhtëm: Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik një deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë që jemi dakort me grafikun e realizimit të kontratës.
2. Operatori “Muca” Shpk, me NIPT K01421002H nuk përmbush asnjë nga kriteret e kërkuara në dokumentat e tenderit, dhe për rrjedhojë KVO vendosi të mos e kualifikojë këtë ofertë.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“Univers Promotions” Shpk me NIPT K81324039M**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 8 759 000 (tetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Portual Durrës, me adresë Lagja nr.1, Rruga Tregtare, Durrës, me tel 052706422, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraprak)

PO



JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Pirro Vengu**